



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA UJËSJELLËS KANALIZIME MEMALIAJ SH.A
AKSIONARI

Memaliaj më 03/05/2023

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Nr. 2, date 03/05/2023

Në mbështetje të, Ligjit, Nr. 9901/2008 “ Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” Neni 135, pika 2/c si dhe të Statutit të Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Memaliaj Sh.a, sot, më datë 03/05/2023, Ujësjetllës Kanalizime Memaliaj Sh.a, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me M09831502C, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga likuidatori dhe administratori i shoqërisë zoti, Petrit Shaha për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Çështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Memaliaj Sh.a nuk zhvillon më aktivitet ekonomik e administrativ dhe ofrimin e shërbimit ndaj qytetarëve pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 2426Rep. dhe Nr. 802 Kol, datë 02.11.2022 midis shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Memaliaj Sh.a dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastrë Sh.a, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivitet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 31.12.2022, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të prishet dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Ortaku i Vetëm vendosi:

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Emërimin e Z. Petrit Shaha si likuidator të shoqërisë.

(4) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likudimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likudimin e shoqërisë.

Pasi u siguroa se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon:

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONAREVE
AKSIONAR I VETEM
PERFAQESUAR NGA**

KRYETARI

Gjolek GUCI

